

Mbikëqyrje Publike
mbi Prokurimet Publike:

Studime të rasteve

Botimi nr. 2

01

Për një periudhë prej 5 vitesh, qytetarët kanë paguar 73 milionë euro për dokumente personale bazuar në një tender 21-vjeçar dhe kontrata që janë "konfidenciale"



02

Fluturimet me vlerë 1 milion euro për evakuimin e shtetasve nga Lindja e Mesme, të paguara në avancë, mbi limitin ligjor



03

Objekti i pishinës shkollore në Çair, me vlerë prej 890 mijë euro, 6 muaj ishte i përfunduar vetëm në letër



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации

Botim elektronik:

Mbikëqyrje publike mbi Prokurimet Publike:

Studime të rasteve

Botimi nr. 2

Botuesi:

Qendra për Komunikime Qytetare

Redaktor:

German Fillkov

Autorë:

Sabina Fakiq dhe German Fillkov

Ekipi i hulumtuesve:

Pavlinka Strezoska dhe Marko Mitevski

Bartësi i të drejtave të autorit:

Qendra për Komunikime Qytetare

Përkthim nga maqedonishtja në shqip:

Agon Ismaili

Dizajni: Relativ

Botuar: Shkup, qershor 2026

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

35.073.53:005.584.1(497.7)(047)

ФАКИЌ, Сабина

Јавен надзор над јавните набавки [Електронски извор] : студии на случај : издание бр. 2 / [автори Сабина Факиќ и Герман Филков ; истражувачки тим Павlinka Стрезоска и Марко Митевски ; превод од македонски на албански јазик Агон Исмаили ; превод од македонски на англиски јазик Магдалена Симионска]. - Текст во ПДФ формат, содржи 27, 27, 27 стр., илустр. - Скопје : Центар за граѓански комуникации, 2026

Начин на пристапување (URL):

https://www.ccc.org.mk/wp-content/uploads/2026/06/javen-nadzor-nad-javnite-nabavki_studii-na-sluchaj_izdanie-br-2.pdf.

- Фусноти кон текстот. - Текст на мак, алб. и англ. јазик. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 17.06.2026 год. - Содржи и: Mbikëqyrja publike mbi prokurimet publike : studime të rasteve : botimi nr. 2 ; Public oversight of public procurement : case studies : issue no. 2

ISBN 978-608-4974-56-7

1. Филков, Герман [автор]

а) Јавни набавки -- Мониторинг -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 6894618

Përmbajtja

Hyrje.....	4
------------	---

Për një periudhë prej 5 vitesh, qytetarët kanë paguar 73 milionë euro për dokumente personale bazuar në një tender 21-vjeçar dhe kontrata që janë “konfidenciale”	5
---	---

Një tender për prodhimin e dokumenteve personale nuk është realizuar që nga viti 2005.....	7
--	---

Ministria e Punëve të Brendshme i klasifikon si “konfidenciale” kontratat për prokurimin e formularëvetë dokumenteve personale për qytetarët e Maqedonisë.....	8
--	---

Rritje e shpenzimeve për formularët e lëshuar dhe për mirëmbajtjen e sistemit.....	10
--	----

Fluturimet me vlerë 1 milion euro për evakuimin e shtetasve nga Lindja e Mesme, të paguara në avancë, mbi limitin ligjor.....	12
---	----

Konkurrenca e penguar.....	14
----------------------------	----

Pagesa e bërë në avancë për fluturimet nuk ka qenë e paraparë në dokumentacionin e tenderit, ndërsa nuk është as në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike.....	18
---	----

Objekti i pishinës shkollore në Çair, me vlerë prej 890 mijë euro, 6 muaj ishte i përfunduar vetëm në letër	21
---	----

Njoftimi për kontratën e realizuar nuk e pasqyron realitetin.....	22
---	----

Kronologjia e tenderit për ndërtimin i pishinës së mbyllur shkollore.....	27
---	----

Hyrje

Korrupsioni në prokurimet publike në Maqedoninë e Veriut vazhdon të jetë një problem serioz sistemik që drejtpërsëdrejti e dëmton sundimin e ligjit, e zvogëlon besimin e qytetarëve në institucionet dhe çon në shpenzimin joracional të mjeteve publike si dhe keqpërdorimin e tyre. Pavarësisht angazhimeve të shumta deklarative për të luftuar korrupsionin, praktika institucionale ende nuk tregon përparim të mjaftueshëm sistematik dhe të vazhdueshëm në zbulimin, veprimin kundër dhe sanksionimin e praktikave korruptive, veçanërisht në sferën e prokurimeve publike, e cila mbetet fusha më e lëndueshme sipas analizave kombëtare me fokus në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë viteve të fundit, në vend që në mënyrë konsistente të përforcoheshin mekanizmat e kontrollit dhe parandalimit, janë vërejtur procese që në mënyrë plotësuese i zvogëlojnë mundësitë për mbikëqyrje efektive dhe sanksionim të keqpërdorimeve në prokurimet publike. Zbatimi i pamjaftueshëm i mekanizmave ligjorë ekzistues krijon një mjedis në të cilin prania e korrupsionit mund të vazhdojë dhe të përhapet. Në veçanti shqetëson fakti që, pavarësisht se ekzistojnë disa organe kompetente për parandalimin dhe sanksionimin e korrupsionit, praktika tregon se reagimet shpesh herë janë të ngadalta, selektive ose jo mjaftueshëm efektive për të siguruar sanksionimin real të shkeljeve dhe parandalimin efektiv të abuzimeve në të ardhmen. Rëndësia e kësaj çështjeje buron nga fakti se prokurimet publike paraqesin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të shtetit dhe ato përdoren në të gjithë sektorët e shpenzimeve publike, nga shëndetësia dhe arsimi deri te infrastruktura dhe energjetika.

Në kuadër të projektit “Mbikëqyrje publike mbi Prokurimet Publike”, analizohen disa raste konkrete të procedurave të tenderimit të cilat mund të jenë zhvilluar në mënyrë të paligjshme, e në të cilat kujdesi për paratë publike nuk ka qenë parësor. Këto raste veçohen nëpërmjet analizës së zhvilluar mbi të dhënat e paraqitura nga flamujt e kuq të aplikuara nga Byroja për Prokurime Publike, përmes hulumtimeve të bazuara në informacionet e disponueshme publike, si dhe përmes konsultimeve me qytetarët. Prezantimi publik i këtyre rasteve ka për synim jo vetëm informimin e publikut, por edhe të krijojë presion më të madh mbi institucionet për të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për sanksionimin e tenderëve të zhvilluar në mënyrë të paligjshme, si dhe për zbatimin konsistent të dispozitave ligjore dhe për vendosje të standardeve më të larta për transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi.

Përmes rasteve të tenderëve konkretë që do të bëhen publike për qytetarët dhe do t’u dorëzohen institucioneve kompetente, synimi është të kontribuohet në drejtim të kapërcimit të dobësive të vazhdueshme në reagimin institucional, proaktivitetit të pamjaftueshëm në detektimin e abuzimeve dhe efikasitetin e kufizuar në zbatimin e procedurave ligjore në prokurimet publike. Në këtë mënyrë, do të kontribuohet në drejtim të forcimit të rolit të shoqërisë qytetare, përkatësisht në drejtimin që mediat dhe qytetarët të ushtrojnë mbikëqyrje aktive mbi shpenzimin e mjeteve publike, me qëllim të minimizimit të mundësive për ndikim politik, keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe praktikave korruptive në sektorin publik.

Për një periudhë prej 5 vitesh,
qytetarët kanë paguar 73 milionë euro
për dokumente personale bazuar
në një tender 21 -vjeçar dhe kontrata
që janë "konfidenciale"



- Prodhimi i pasaportave, letërnjoftimeve dhe patentave të shoferit në pesë vitet e fundit, Ministrisë së Punëve të Brendshme i kushtoi 29 milionë euro, ndërsa për t'i marrë këto dokumente, qytetarët kanë paguar 73 milionë, apo 44 milionë euro më tepër.
- Pjesa më e madhe e asaj shume prej 73 milionë euro që është paguar nga qytetarët është për marrjen e pasaportës, madje 60 milionë euro për 5 vite.
- Dokumentet i prodhon një kompani gjermane që e fitoi tenderin 21 vit më parë. Ministria e Punëve të Brendshme nuk e bën të ditur informacionin se kur dhe në çfarë kushtesh kontrata e parë është vazhduar deri më sot.
- Ministria e Punëve të Brendshme nuk i bën publike as kontratat që janë në fuqi për prodhimin e dokumenteve personale, me arsyetimin se ato janë të klasifikuara si “konfidenciale”.
- Ministria konsideron se publikimi i të dhënave nga kontratat e nënshkruara do të ketë pasoja për operacionet e tyre, pa e cekur se për cilat pasoja bëhet fjalë.
- Edhe numri i dokumenteve personale (pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi) që janë lëshuar vitet e fundit është informacion i mbrojtur nga publikimi si “konfidencial”. Ministria e Punëve të Brendshme i bënë të ditura vetëm të dhënat e përgjithshme financiare.
- Me këtë fshehtësi në lidhje me tërë marrëveshjen dhe anekset e saj, kufizohet këqyrja e publikut mbi aspektet financiare dhe kontraktuale të këtij prokurimi.
- Nuk është e qartë se në bazë të cilit ligj është zbatuar ky prokurim, që është i përjashtuar nga procedurat e rregullta konkurruese për prokurim. Prandaj, publiku nuk mund të verifikojë nëse përjashtimi nga rregullat e zakonshme ka qenë ligjërish i justifikuar, i nevojshëm dhe proporcional.
- Me mbajtjen e fshehtësisë për numrin e formularëve të dokumenteve të siguruara kufizohet kontrolli publik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore. Në qoftë se nuk dihet se sa formularë janë siguruar, është e pamundur të vlerësohet nëse çmimi është i arsyeshëm dhe nëse kontrata është e justifikuar ekonomikisht.
- Në pesë vitet e fundit, MPB-ja i ka paguar furnizuesit 29 milionë euro, që është më tepër se shuma të cilën e ka paguar për 11 vitet e para të kontratës. Kjo e shtrën pyetjen nëse janë rritur çmimet për formularët dhe mbështetjen teknike nga kompania furnizuese ose janë rritur sasitë e tyre.
- Të disponueshme për publikun janë vetëm kontratat për mbështetje teknike për sistemin elektronik të dokumenteve personale, e të cilat janë nënshkruar në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike nëpërmjet procedurës së negociuar pa publikim të shpalljes, me kompaninë Veridos GmbH.
- Në periudhën 2018-2020, MPB-ja zbatoi pesë tenderë të pasuksesshëm për “shërbime konsulence për përgatitjen e dokumentacionit të projektit që do të përdoret në realizimin e prokurimit të shërbimeve për prodhimin e dokumenteve biometrike.” Të pesë ofertat u anuluan si rezultat i mungesës së ofertave të pranueshme.
- Në vend që të zhvillojë një procedurë të re të prokurimit publik, Ministria e Punëve të Brendshme aktualisht, nëpërmjet një studimi për realizueshmëri po i shqyrton mundësitë që i gjithë procesi, nga prodhimi deri te lëshimi i dokumenteve personale, të zhvillohet në territorin e shtetit.

Një tender për prodhimin e dokumenteve personale nuk është realizuar që nga viti 2005

Ligji për Prokurimet Publike i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian, i referohet një niveli të lartë të llogaridhënies dhe transparencës në prokurimet publike, mirëpo për vite me radhë, qytetarët maqedonas nuk e kanë ditur se në bazë të cilave dhe çfarë kontratash si dhe në çfarë kushtesh prokurohen formularët për dokumentet personale (pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi). Që në vitin 2005 tenderi iu dha kompanisë gjermane Giseke + Devrient (Giesecke+Devrient).

Sipas komunikatës së vetë kompanisë, të publikuar më 30 nëntor 2005, kontrata ka qenë e nënshkruar për një periudhë 11-vjeçare: “Qeveria e Republikës së Maqedonisë i akordoi grupit ndërkombëtar teknologjik “Giesecke & Devrient” (G&D) një kontratë për ta siguruar vendin me pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi që do të ishin elektronike, si dhe me një sistem të përshtatshëm të kombinuar për personalizimin e dokumenteve. Puna në këtë projekt është planifikuar të fillojë këtë vit, ndërsa projekti parashikohet të zgjasë gjithsej 11 vjet. Pasaportat dhe letërnjoftimet e para elektronike tashmë duhet t’u lëshohen qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në vitin 2006. Porosia përfshin livrimin e 1.5 milion dokumenteve për pasaporta me mikroçipa të integruar, 1.8 milion letërnjoftime dhe 500,000 patenta shoferi. Përveç dokumenteve, G&D do të furnizojë pajisje për personalizim të centralizuar dhe mbledhje të decentralizuar të të dhënave, si dhe për ruajtjen dhe përgatitjen e centralizuar të të dhënave. Prodhuesi ndërkombëtar i kartave inteligjente gjithashtu do të përkujdeset për integrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit përmes një kontrate për mirëmbajtje.”¹

Sipas komunikatës në fjalë, vlera e kontratës së përgjithshme 11-vjeçare është 23.5 milionë euro.²

Bazuar në këtë rezulton që kontrata e nënshkruar fillimisht për livrimin e formularëve për dokumente personale ka skaduar në vitin 2016. Që atëherë, Ministria e Punëve të Brendshme nuk i ka bërë publike kushtet sipas të cilave kontratat janë vazhduar pas skadimit të tyre.

Në vend që të zhvillonte një tender të ri pas skadimit të kontratave fillestare, në periudhën 2018-2020, Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar shpallje për gjithsej pesë procedura me lëndën “Shërbime konsulence për përgatitjen e dokumentacionit të projektit që do të përdoret në prokurimin e shërbimeve për prodhimin e dokumenteve biometrike.” Të pesë procedurat kanë qenë të anuluar me arsyetimin se nuk është parashtruar asnjë ofertë e pranueshme. Pas anulimit, Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka shpallur një procedurë të re për prokurimin e formularëve për dokumente personale, por ka vazhduar të punojë me të njëjtin furnizues pa një shpallje publike dhe pa zbatuar procedurë konkurruese.

1 <https://www.securetechalliance.org/new-ids-for-macedonia/>

2 <https://www.securetechalliance.org/electronic-passport-production-kicks-off-in-macedonia/#>

Për publikun, të disponueshme janë vetëm kontratat për mbështetjen teknike dhe mirëmbajtjen e sistemit të vetëm elektronik për dokumentet personale, që janë lidhur me kompaninë Veridos GmbH, e themeluar nga Giesecke+Devrient. Kontratat janë lidhur nëpërmjet procedurës së negociuar pa publikim paraprak të shpalljes, me një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Kontratat e nënshkruara në vitet 2021 dhe 2024 janë publikuar në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike.

Ndërkohë, nuk ka njoftim për ndonjë tender të ri për prodhimin e dokumenteve personale. Në prill të vitit 2025, Ministria ka nënshkruar një marrëveshje me kompaninë për konsulencë “Target Komunikaci” Shkup për shqyrtimin e mundësive që i gjithë procesi, nga prodhimi deri te lëshimi i dokumenteve personale, të zhvillohet në territorin e shtetit.

Ministria e Punëve të Brendshme i klasifikon si “konfidenciale” kontratat për prokurimin e formularëve të dokumenteve personale për qytetarët e Maqedonisë

Qendra për Komunikime Qytetare ka paraqitur një kërkesë deri te Ministria e Punëve të Brendshme më 6.4.2026 për të gjitha të dhënat relevante lidhur me prokurimin për lëshimin e dokumenteve personale. Megjithatë, Ministria e Punëve të Brendshme i ka shpallur 3 kërkesat kryesore si informacion i klasifikuar me një nivel të caktuar të klasifikimit. Këtu bëhet fjalë për informacionet e mëposhtme:

1. Të gjitha kontratat (bazë dhe anekset) që Ministria e Punëve të Brendshme i ka lidhur me operatorin ekonomik Giesecke+Devrient për prokurimin e formularëve të dokumenteve personale (pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi);
2. Bazuar në cilin ligj janë lidhur kontratat me operatorin ekonomik Giesecke+Devrient për prokurimin e formularëve të dokumenteve personale (pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi)?
3. Numri i formularëve të dokumenteve personale (pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi) të prokuruar në periudhën 2021 - 2025, me të dhëna për secilin prej tre llojeve të dokumenteve personale ndaras, në nivel vitesh.

Në përgjigjen nga MPB-ja thuhet që: “Një pjesë e informacionit të kërkuar është informacion që, bazuar në Ligj, paraqet informacion të klasifikuar me një nivel të caktuar klasifikimi. Pyetjet me numrat rendorë 1, 2 dhe 3 janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “konfidenciale”. Ministria gjithashtu informon se është kryer testi i detyrueshëm “testi i dëmit”, duke konstatuar se me dhënien e një pjesë të informacionit të kërkuar do të ketë pasoja për punën e Ministrisë.

Megjithatë, sipas Ligjit për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, nëse ndonjë dokument ose një pjesë e tij përmban informacione konfidenciale, ato informacione duhet të veçohen nga dokumenti dhe kërkuar të jepen përmbajtja e pjesës tjetër të dokumentit.

Pra, nëse kontratat e nënshkruara përmbajnë specifitime teknike, elemente sigurie, karakteristika mbrojtëse të formularëve, metoda të personalizimit ose detaje tjera të ndjeshme që ndërlidhen me sigurinë e dokumenteve personale, ato pjesë specifike mund të mbrohen. Megjithatë, kjo nuk donë të thotë se e gjithë kontrata, duke përfshirë të dhënat bazë mbi lëndën e prokurimit, vlerën, kohëzgjatjen, palët kontraktuese, anekset, metodën e nënshkrimit të kontratës dhe detyrimet e autoritetit kontraktues, duhet të jenë automatikisht të paakseshme për publikun.

Veçanërisht e rëndësishme është që të theksohet se këtu nuk bëhet fjalë për informacione të rëndomta administrative, por për një prokurim që drejtpërsëdrejti i ndikon të gjithë qytetarët. Qytetarët jo vetëm që e financojnë punën e autoriteteve kontraktuese përmes fondeve buxhetore, por edhe drejtpërdrejtë nga xhepat e tyre paguajnë për marrjen e dokumenteve personale. Prandaj, ata kanë të drejtë legjitime të dinë se sa është shuma që paguhet për formularët, në çfarë mënyre janë lidhur kontratat, mbi çfarë baze ligjore është përzgjedhur operatori ekonomik dhe nëse prokurimi është realizuar në mënyrë që siguron shpenzim racional të parave publike.

Gjithashtu, nëse Ministria e Punëve të Brendshme ka vendosur ta realizojë këtë prokurim në këtë mënyrë, atëherë është thelbësore që t'u shpjegohet qytetarëve se cili ligj dhe dispozitë ligjore është zbatuar. Përndryshe, publiku nuk mund të verifikojë nëse përjashtimi nga rregullat e zakonshme ka qenë ligjërish i arsyetuar, i nevojshëm dhe proporcional. Zbardhja e këtij informacioni mund të bëhet edhe pa zbuluar detaje të tjera të ndjeshme të procedurës.

Sa i përket çështjes me numrin e formularëve të prokuruar për pasaporta, letërnjoftime dhe patenta shoferi në secilin vit, duhet të bëhet dallim mes informacioneve të ndjeshme operative dhe të dhënave statistikore. Kërkesa për informacion ishte në lidhje me numrin e formularëve të prokuruar sipas llojit të dokumentit dhe sipas vitit të prokurimit, ndërkaq jo me karakteristikat konkrete të sigurisë, numrat serikë, logjistikën, dërgesat, vendet e magazinimit ose detajet teknike të prodhimit. Prandaj, nuk është e qartë pse numri i përgjithshëm i formularëve të prokuruar mund të paraqesë informacion të klasifikuar, kur numri i tyre është bërë publik në vitin 2005. Pa këto të dhëna, publiku nuk mund të bëjë vlerësimin nëse sasi të janë planifikuar në bazë reale, nëse prokurimi ka qenë i tepërt apo i mangët dhe nëse paratë e tyre janë shpenzuar në mënyrë ekonomike. Në të njëjtën kohë, sasia paraqet një parametër thelbësor për përcaktimin e çmimit dhe arsyeshmërisë financiare të prokurimit.

Rritje e shpenzimeve për formularët e lëshuar dhe për mirëmbajtjen e sistemit

Në bazë të kërkesës së paraqitur për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme i paraqiti të dhënat lidhur me vlerën e parave për dokumentet personale të prodhuara që MPB-ja ia ka paguar furnizuesit dhe të cilën qytetarët ia kanë paguar Ministrisë së Punëve të Brendshme për dokumentet që e lëshuara.

Një krahasim që është bërë mbi shpenzimet në nivel vitesh nxjerr në pah një rritje të konsiderueshme të fluksit financiar dalës. Kontrata e vitit 2005 kishte një vlerë prej 23.5 milionë euro për 11 vjet, që donë të thotë se shpenzimet janë paraparë të jenë mesatarisht nga 2.1 milionë euro në vit. Në 5 vitet e fundit, Ministria e Punëve të Brendshme ka paguar gjithsej 29 milionë euro për formularët dhe mirëmbajtjen e sistemit — përkatësisht mesatarisht nga 5.8 milionë euro në nivel vjetor.

Shumat e paguara nga MPB-ja për dokumentet personale të prodhuara (në euro)

Viti	Për pasaportat	Për letërnjoftimet	Për patentat e shoferit	Përkrahje dhe mirëmbajtje e sistemit	Totali
2021	3,466,709	621,732	62,328	933,356	5,084,125
2022	4,611,687	394,470	344,515	1,231,618	6,582,290
2023	2,866,154	465,802	146,367	1,454,070	4,932,394
2024	6,748,837	670,957	267,773	1,477,000	9,164,567
2025	1,843,314	164,656	117,397	1,620,000	3,745,367
Totali	19,536,702	2,317,455	938,379	6,716,044	29,508,580


Përveç rritjes së shpenzimeve, edhe më problematik është fakti se në periudhën 2021-2025, ndërsa shteti i ka paguar furnizuesit gjithsej 29 milionë euro, nga qytetarët ka inkasuar madje 73 milionë euro - përkatësisht, 44 milionë euro më tepër.

Shumat që MPB-ja i ka inkasuar prej qytetarëve për dokumente personale (në euro)

Viti	Për pasaportat	Për letërnjoftimet	Për patentat e shoferit	Totali
2021	8,474,854	1,015,817	336,838	9,827,509
2022	10,710,114	1,206,719	1,413,490	13,330,323
2023	13,358,350	1,437,639	991,705	15,787,694
2024	22,241,293	3,005,628	1,950,519	27,197,439
2025	5,893,545	735,659	638,427	7,267,630
Totali	60,678,154	7,401,462	5,330,979	73,410,595

Vështruar në bazë vjetore, edhe qytetarët edhe Ministria e Punëve të Brendshme i kanë pasur shpenzimet më të larta për lëshimin e dokumenteve personale në vitin 2024. Atë vit, qytetarët kanë paguar 27 milionë euro, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme 9 milionë euro. Dallimet më të mëdha midis shpenzimeve të MPB-së dhe parave të arkëtuara nga qytetarët janë regjistruar tek lloji i dokumenteve të pasaportave. Qytetarët kanë paguar madje 60 milionë euro për to në 5 vitet e fundit (2021-2025), përkatësisht 82 % të shpenzimeve të përgjithshme që i kanë bërë për dokumentet personale.

Shumat e paguara nga MPB-ja dhe nga qytetarët për dokumente personale
(në milionë euro)



Ministria e Punëve të Brendshme i ka shlyer rregullisht detyrimet e saj – me përfundim më 31 dhjetor të vitit 2025 MPB-ja nuk ka fatura të maturuara, ndërsa të papaguara, për formularët e dorëzuar dhe për mbështetjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të dokumenteve personale ndaj furnizuesit.

Fluturimet me vlerë
1 milion euro për evakuimin
e shtetasve nga Lindja e Mesme,
të paguara në avancë,
mbi limitin ligjor



(Tender i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë
së Jashtme për shërbime për huazim të aeroplanit për
transportimin dhe evakuimin e qytetarëve të Maqedonisë
nga rajoni i Lindjes së Mesme i prekur nga operacionet
luftarake nëpërmjet një procedure të negociuar pa
publikim paraprak të shpalljes)

- Fluturimet për evakuimin prej në Dubai dhe Riad në mars të vitit 2026 janë paguar në avancë, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimet Publike, me të cilin është paraparë që shuma maksimale e avancës mund të jetë deri 20 % të vlerës së kontratës.
- Pagesat në avancë nuk kanë qenë të siguruara me garanci bankare siç parashihet me Ligjin dhe nuk kanë qenë paraprakisht të parapara në dokumentacionin e tenderit.
- Për fluturimet e evakuimit janë zhvilluar një tender i pasuksesshëm dhe një i suksesshëm, pas të cilit është nënshkruar kontrata për marrjen me hua të aeroplanëve.
- Tenderët janë zhvilluar në suazat e Ligjit për Prokurimet Publike, me të cilin, për situatat urgjente lejohet kontaktimi i drejtpërdrejtë i kompanive. Megjithatë, dokumentet zbulojnë një sërë vendimesh, të cilat si një tërësi, kanë penguar konkurrencën e vërtetë.
- Në procedurën e parë, e cila është iniciuar më 4 mars të vitit 2026, janë kërkuar oferta nga nëntë kompani. Atyre kompanive kërkesa u është dërguar pas orës 16:00, në adresat e tyre të përgjithshme të kontaktit, me afat për dorëzimin e ofertave deri në orën 11:00 të mëngjesit të nesërme.
- Nuk janë të qartë kriteret mbi bazën e të cilave Ministria e Punëve të Jashtme e ka bërë përzgjedhjen e këtyre nëntë kompanive, duke e pasur parasysh se asnjëra prej tyre nuk ka kontratë aktuale për ofrimin e shërbimeve të fluturimit me ndonjë institucion shtetëror. Për më tepër, nuk është e qartë pse lista e kompanive nga të cilat janë kërkuar ofertat nuk i përfshinte operatorët më të rëndësishëm për zonën e krizës - FlyDubai dhe FlyNas.
- Pasi nuk fitoi asnjë ofertë, MPJ-ja e ka anuluar procedurën dhe në të njëjtën ditë (5 mars) ka iniciuar një procedurë të re. Në procedurën e dytë, kërkesa për dorëzimin e ofertës i është dërguar vetëm një kompanie — Avialog Skopje, për të cilën MPJ-ja pretendon se ka mësuar që është përfaqësuese e FlyDubai. Si dëshmi për lidhjen midis Avialog dhe FlyDubai, MPJ-ja ka paraqitur një kartelë angazhimi në FlyDubai, e cila i përket një personi fizik — themeluesit të Avialog, por që nuk dëshmon ndonjë lidhje afariste ose ligjore ndërmjet dy kompanive.
- Ditën e nesërme, më 6 mars, në orën 14:00, kompania dorëzon një ofertë, të njëjtën atë ditë më vonë janë zhvilluar negociatat, është nënshkruar kontrata, është lëshuar faturë me datat për 2 fluturimet e para dhe është bërë pagesa e faturës nga Ministria e Punëve të Jashtme.
- Vlera e komisionit që e ka marrë kompania me të cilën MPJ-ja ka nënshkruar kontratën nuk është informacion i disponueshëm për publikun, sepse MPJ-ja ka devijuar nga koncepti i zakonshëm i kontratave për prokurimin publik të biletave të fluturimit dhe huazim të aeroplanit. Në to zakonisht shënohet komisioni i agjencisë që inkasohet mbi çmimin e biletës së fluturimit ose të avionit që merret me hua.
- Fillimisht, MPJ ka vlerësuar që evakuimi i shtetasve të Maqedonisë do të kushtonte 60 milionë denarë. Oferta e vetme që e kishte fituar ka qenë me vlerën 59,799,900 denarë, përkatësisht vetëm për 0.33 % më pak.
- Kostoja e transportit me aeroplan ka qenë - 211,000 euro për një fluturim për aeroplanin e huazuar me qira nga FlyDubai, modeli "Boeing 738-MAX" dhe 260,000 euro për avionin e FlyNas "Airbus 320", duke përfshirë kostot për akomodimin gjatë natës dhe transportin me autobus.
- Shpenzimet për evakuimin, në vendin tonë janë mbuluar krejtësisht nga ana e shtetit, ndërsa në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, pasagjerët e transportuar kanë participuar në këto harxhime.

- 590 pasagjerët janë transportuar me katër fluturime – tre nga Dubai në Shkup dhe një nga Riadi në Prishtinë. Rezulton se kostoja e evakuimit për çdo pasagjer prej në Dubai ka qenë 1.548 euro, ndërsa prej në Riad ka qenë 1.960 euro.
- Edhe pse kontrata për prokurimet publike parasheh evakuimin e shtetasve të Maqedonisë, janë transportuar edhe 42 shtetas të huaj të vendeve fqinjë.

Konkurrenca e penguar

Në përputhje me Konkluzionin e Qeverisë, të seancës së 154-të nga 3 marsi i vitit 2026, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme është e angazhuar të zhvillojë një procedurë negociuese pa publikim të shpalljes për prokurim publik të shërbimeve për huazim të një aeroplani për transportimin dhe evakuimin e shtetasve maqedonas nga rajoni i prekur nga operacionet luftarake në përputhje me nenin 55, paragrafi (1), pika d) dhe nenin 55, paragrafi (6) të Ligjit për Prokurimet Publike. Në të njëjtën kohë, Ministria e Financave është e angazhuar të sigurojë resurse financiare në Buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme për realizimin e këtij prokurimi publik.

Vlera e përlogaritur e prokurimit publik prej 60 milionë denarësh, sipas informacioneve që janë dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme, është përcaktuar në bazë të të dhënave nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Maqedonisë në Abu Dabi dhe Doha për numrin e përafërt të shtetasve të Maqedonisë (rreth 600 persona) që duhet të evakohen nga rajoni i Lindjes së Mesme, të dhëna të publikuara edhe në mediat në kohën para realizimit të prokurimit publik, si dhe organizimin e mundshëm të kufizuar të fluturimeve të disponueshme nga rajoni (Dubai dhe Riad) si dhe çmimet për dhënie në huazim të aeroplanëve nga fluturimet tashmë të kryera më parë nga destinacionet e listuara deri në Evropë.

Bazuar në konkluzionin e qeverisë, ditën e nesërme, më 4 mars 2026, Ministria e Punëve të Jashtme sjell Vendim për prokurim publik dhe deri te 9 operatorë ekonomikë dërgon një ftesë për dorëzim të ofertave për huazim të një aeroplani, me përmbajtjen e mëposhtme: “Në lidhje me situatën aktuale në Lindjen e Mesme, për shkak të së cilës një numër i madh i shtetasve të Maqedonisë gjenden në vende që janë nën sulm ose në rrezik nga sulme të mëtejshme nga Irani, prej fillimit të konfliktit, rreth 500 shtetas të Maqedonisë kanë raportuar nevojën për evakuim nga rajoni, përkatësisht nga Izraeli, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari, Kuvajti dhe Bahreini, por aktualisht nuk ekzistojnë mundësi për evakuim nëpërmjet komunikacionit ajror. Ju ftojme që më së voni deri të nesërmen, më 5.3.2026 të dorëzoni një ofertë për prokurim të shërbimeve për huazim me qira të një avioni për transportimin dhe evakuimin e shtetasve të Maqedonisë nga rajoni i Lindjes së Mesme, i prekur nga operacionet luftarake, siç është shënuar në dokumentacionin e tenderit dhe specifikimin teknik. Oferta dhe Deklarata duhet të dërgohen të skanuara, të vërtetuara me numër arkivor, vulë dhe nënshkrim të personit përgjegjës ose të ndonjë personi të autorizuar nga personi përgjegjës deri në afatin e përcaktuar saktësisht në e-mail adresat.”

Kërkesat për dorëzimin e ftesave janë dërguar në periudhën kohore nga ora 15:57 deri në orën 17:28 me kërkesën që të dorëzohet një ofertë mëngjesin e nesërm deri në orën 11:00. Sipas kësaj, rezultoi që kompanitë duhej të paraqisnin një ofertë në afat prej pak se 24 orësh.

Lista dhe koha e ftesave të dërguara

Data dhe ora e dërgimit të ftesës/email-it	Emërtimi i operatorit ekonomik	Adresa e ftesës
04.03.2026 në orën 15:57	Qendra Rajonale Aeronautike Shkup	tamara@arcmk.com
04.03.2026 në orën 16:00	Turkish Airlines	costomer2@thy.com
04.03.2026 në orën 16:14	Croatia Airlines	contact@croatiaairlines.hr
04.03.2026 në orën 16:20	Wizz Air	info@wizzair.com
04.03.2026 në orën 16:25	DPTU Nova Travel-MS SHPK Strumicë	novatravel.ms@gmail.com, novatravel@t.mk
04.03.2026 në orën 16:30	Aurora Turs Shkup	info@aurora.com.mk
04.03.2026 në orën 16:33	Pegasus Airlines	info@flypgs.com
04.03.2026 në orën 16:35	TA Condor Shkup	kondorturisticka@gmail.com
04.03.2026 në orën 17:28	TA Papillon Shkup	papillon@papillon.com.mk

Kompanive, nga të cilat janë kërkuar oferta, u janë dhënë udhëzimet dhe kërkesat e mëposhtme:

- Huazim të një aeroplani me kapacitet pasagjerësh për të paktën 150 persona, në linjën Dubai-Shkup (sasia e prituri 3) dhe huazim të një aeroplani me kapacitet pasagjerësh për të paktën 150 persona, në linjën Riad-Shkup (sasia e prituri 1).
- Prokurimi për shërbimet e huazimit të aeroplanit për transportimin dhe evakuimin e shtetasve të Maqedonisë prej rajonit të Lindjes së Mesme i prekur nga operacionet luftarake do të realizohet menjëherë pasi të sigurohet një korridor i sigurt ajror për fluturim nga destinacionet e listuara.
- Autoriteti kontraktues do ta bën pagesën brenda afatit më të shkurtë të mundur pas kryerjes së shërbimeve dhe pasi të dorëzohet faturë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Për të vërtetuar aftësinë e tyre profesionale, kompanitë duhet të paraqesin një Deklaratë që duhet të vërtetojë se ofertuesi është i regjistruar për veprimtarinë, se kompania e fluturimeve ka licencë për fluturime ndërkombëtare në emër të kompanisë së fluturimeve dhe se vërtetohet serioziteti i ofertës.
- Çmimi i ofruar duhet t'i përfshijë të gjitha harxhimet dhe lirimet e operatorit ekonomik, të paraqitet pa tatimin mbi vlerën e shtuar në denarë, ndërsa këtë tatim e paraqet veçmas.
- Kriteri për dhënien e kontratës për prokurimin publik për të gjithë kohëzgjatjen e procedurës është oferta ekonomikisht më e favorshme. Oferta ekonomikisht më e favorshme përcaktohet në bazë të çmimit më të ulët.

Ministria e Punëve të Jashtme ka informuar se në afatin e caktuar asnjë operator ekonomik i ftuar nuk ka dorëzuar ofertë. Përveç kësaj, nga dokumentacioni i paraqitur, e dukshme ishte vetëm përgjigja e paraqitur nga agjencia turistike Papillon, ku ata kanë thënë: *“Ju informojmë se nuk kemi mundësi t’ju paraqesim një ofertë, sipas kërkesës suaj. Ju rekomandojmë që si Ministri të kontaktoni drejtpërdrejt me kompanitë e fluturimit, të cilat mund të sigurojnë licenca të përshtatshme për uljen e aeroplanëve në aeroporte me shkallë të caktuar të rrezikut”*. Nuk ka informacione nëse ky rekomandim është zbatuar.

Në këtë procedurë të prokurimit publik, megjithëse disa operatorë ekonomikë kanë qenë të ftuar formalisht, përzgjedhja e ofertuesve, të cilëve u është dërguar ftesa për të paraqitur një ofertë nuk nënkupton që realisht është krijuar bazë për konkurrencë, duke e pasur parasysh se disa nga subjektet që kanë qenë të ftuar nuk kanë kapacitet të drejtpërdrejtë tregu për të ofruar shërbimin në fjalë, ndërkaj nuk kanë qenë të ftuar operatorë relevantë me kontakt të drejtpërdrejtë tregu me rajonin.

Më 5.3.2026, Ministria e Punëve të Jashtme miratoi një vendim për anulimin e procedurës sepse nuk mori asnjë ofertë të vetme dhe miratoi një vendim të ri për realizim të prokurimit publik. Në këtë vendim thuhet: *“Duke e pasur parasysh që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme ka zhvilluar një procedurë të mëparshme prokurimi publik me negocim pa publikim të shpalljes, në të cilën nuk është siguruar asnjë ofertë brenda afatit të përcaktuar, Komisioni për Prokurimet Publike propozoi të niset një procedurë e re me negocim pa publikim të shpalljes derisa të gjendet një ofertë e pranueshme. Duke i pasur parasysh vështirësitë aktuale për gjetje të transportit ajror për objektivin e përcaktuar në lëndën e prokurimit publik, oferta(t) mund të sigurohen nga ndonjë agjenci ndërmjetëse ose drejtpërsëdrejti nga kompanitë e fluturimit.”*

Vendimi nuk përcakton që ofertë do të kërkohej vetëm nga një kompani. Megjithatë, sipas dokumentacionit të fituar dhe sqarimit që është dhënë, kërkesa për dorëzim të ofertës me të njëjtën përmbajtje i është dorëzuar vetëm Avialog Shkup, më 5.3.2026 në orën 16:11 me kërkesën për dorëzimin e një oferte më së voni deri të nesërmen (6.3.2026) deri në orën 14.00 dhe me shënimin se përfaqësuesi i tyre duhet të marrë pjesë në hapjen e ofertave për shkak të negocijimit.

Në përgjigjen e fituar nga Ministria e Punëve të Jashtme thuhet: *“Një ftesë i është dërguar vetëm edhe një operatori ekonomik shtesë (Avialog SHPKPV Shkup), përfaqësues i FLYDubai, sepse sipas të dhënave nga Ambasada e Maqedonisë në Abu Dhabi, vetëm FLYDubai është kompani që ka mundësinë për të organizuar fluturime nga Dubai për në Evropë, ndërkaj e cila gjithashtu organizon fluturime nga Riadi për në Evropë.”*

Si dëshmi për lidhjen midis Avialog dhe FlyDubai, MPJ-ja ka prezantuar një kartelë angazhimi në FlyDubai, e cila i përket një personi fizik - themeluesit të Avialog, por e cila nuk vërteton ndonjë lidhje afariste ose ligjore ndërmjet dy kompanive. Konkretisht, sipas të dhënave në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, kompania që është bartëse e kontratës është 100 % në pronësi të një personi fizik nga Maqedonia. Gjithashtu, edhe në vetë ofertën edhe në faturat e lëshuara, kompania që është bartëse e kontratës nuk i referohet asnjë përfaqësie ose lidhjeje me FLYDubai, veçanërisht duke e pasur parasysh që për fluturimet e evakuimit janë shfrytëzuar edhe shërbimet e kompanisë së fluturimit FlyNas.

Oferta e kompanisë Avialog e ofron atë që kërkohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, duke u përshtatur pothuajse në mënyrë ideale me vlerën e parashikuar prej 60 milionë denarë (975,610 euro). Oferta që është dorëzuar nga Avialog është më e ulët vetëm për 200,000 denarë (3,250 euro), përkatësisht për 0.33 %.

Foto e ofertës së fituar nga ofertuesi i vetëm

SH. Pranojmë që t'i ofrojmë shërbimet si në vijim: - Prokurim për shërbime për huazim me qira të aeroplanit për transport dhe evakuim të shtetasve të Maqedonisë nga rajoni i Lindjes së Mesme që është i prekur nga operacione luftarake					
Nr. rendor	Përshkrimi	Çmimi i përgjithshëm pa TVSH për një fluturim	TVSH	Çmimi me TVSH	Sasia e pritshme
1	Huazim i një aeroplani me kapacitet pasagjerësh për të paktën 150 persona, në linjën Dubai-Shkup	12,954,900 MKD	0		3 fluturime
2	Huazim i një aeroplani me kapacitet pasagjerësh për të paktën 150 persona, në linjën Riad-Shkup	16,000,000 MKD	0		1 fluturim
3	Sigurim shtesë ushtarak	1,233,800 MKD	0		1 fluturim
GJITHSEJ PA TVSH:					59,799,900 MKD
TVSH					0
Gjithsej me TVSH					59,799,900 MKD

Në të njëjtën ditë që është dorëzuar oferta (6.3.2026), Ministria e Punëve të Jashtme e ka nënshkruar kontratën me Avialog Shkup. Po atë ditë (6.3.2026) Avialog e lëshon faturën e parë për 2 fluturimet e para Dubai-Shkup, duke i shënuar datat e realizimit të tyre - 8 dhe 11 mars 2026. Po të njëjtën ditë (6.3.2026), Ministria e Jashtme e ka paguar faturën. Fluturimi i dytë u realizua më 10 mars, mirëpo në faturën mbetet data origjinale.

Siç mund të shihet nga fotoja e ofertës, çmimi për fluturimet prej në Dubai për në Shkup ka qenë 12,954,900 denarë (210,649 euro). Çmimi për një biletë avioni prej në Riad për në Shkup ka qenë 16,000,000 denarë (260,163 euro). Transporti, i cili duhej të ishte realizuar në relacionin Riad-Shkup, por më pas aeroplani ka zbritur në Prishtinë, përfshinte edhe transportin me autobus prej në Doha, Kuvajt dhe Bahrein deri në Riad, si dhe 1 natë qëndrim në Riad.

Për transportin ajror është shfrytëzuar sigurim shtesë ushtarak me vlerë prej 1,233,800 denarë (20,062 euro) për çdo fluturim.

Pagesa e bërë në avancë për fluturimet nuk ka qenë e paraparë në dokumentacionin e tenderit, ndërsa nuk është as në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike

Pagesa avancë e fluturimeve është paraparë në marrëveshjen e nënshkruar (Neni 4), ku thotë: “Pagesa për shërbimet do të bëhet menjëherë para realizimit të shërbimeve, për shkak të kushteve lokale të ofertave nga kompanitë e fluturimeve në Lindjen e Mesme si dhe më gjerë në rajon dhe Evropë, të cilat karakterizohen nga fakti se të gjitha kompanitë e fluturimeve kërkojnë pagesë drejtpërdrejt para përcaktimit të orareve të nisjes së fluturimit.”



Megjithatë, ky nen i marrëveshjes së lidhur midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Avialog nuk është në përputhje me kushtet e paraqitura në dokumentacionin e tenderit, në të cilin është përcaktuar qartë: “Autoriteti kontraktues do ta bëjë pagesën në afatin sa më të shkurtë të mundshëm pasi të jenë kryer shërbimet dhe pasi të jetë dorëzuar faturë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pasqyrë e pagesave avancë për fluturimet e evakuimit

Data e lëshimit të faturës	Data e faturës së paguar	Destinacioni	Data e fluturimit	Vlera e pagesës në denarë	Vlera e pagesës në euro
06.03.2026	06.03.2026	Dubai-Shkup 2 fluturime	8.3.2026 10.3.2026	28,377,400	461,421
09.03.2026	09.03.2026	Riad-Prishtinë	11.3.2026	17,233,800	280,224
13.03.2026	16.03.2026	Dubai-Shkup	17.3.2026	14,188,100	230,701
GJITHSEJ		4 fluturime		59,799,300	972,346

Sipas nenit 116 paragrafi (2) nga Ligji për Prokurimet Publike, kontratë për prokurim publik nënshkruhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe në ofertën. Kjo donë të thotë që pagesa pas kryerjes së shërbimit duhet gjithashtu të paraqitet në kontratë. Kjo gjithsesi nuk do ta kufizonte Avialog që t'i paguan fluturimet nga fondet e veta dhe më pas këto harxhime t'i kompensojë pasi ta ketë inkasuar faturën. Megjithatë, përcaktimi i kushteve konkrete në dokumentacionin e tenderit dhe më pas ndryshimi i tyre në kontratë nuk është në përputhje me LPP-në.

Në të njëjtën kohë, me ndryshimin e bërë janë vendosur në pozitë të pabarabartë të gjitha ato kompani të cilave u është dorëzuar ftesë në procedurën e anuluar. Sipas nenit 7 të LPP-së parashihet që autoriteti kontraktues duhet të sigurojë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik dhe në lidhje me të gjitha pjesët e përfshira në tenderin, duke e pasur parasysh njohjen reciproke dhe proporcionalitetin e kërkesave që ndërlidhen me lëndën e prokurimit. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë ofertuesve në negociata dhe nuk guxon që informacionet t'i sigurojë në mënyrë diskriminuese, me çka disa pjesëmarrës mund të fitojnë avantazh kundrejt të tjerëve. Duke e pasur parasysh që dokumentacioni i tenderit është me rëndësi qenësore në procedurën e prokurimit publik, dokumentacioni duhet t'i përmbajë të gjitha informacionet që janë të domosdoshme për lëndën konkrete të prokurimit në mënyrë që operatori ekonomik të jetë në gjendje që me cilësi dhe në kohë ta përgatisë dhe ta paraqesë ofertën e tij. Prandaj, përgatitja e dokumentacionit të tenderit që nuk është në përputhje me ligjin dhe ka çuar ose mund të kishte çuar në diskriminimin e operatorëve ekonomikë ose kufizim të konkurrencës në treg, përbën një shkelje të rëndësishme mbi ligjin.

Ligji për Prokurimet Publike nuk parasheh që në kushte të procedurës me negociim pa publikim të shpalljes, në përputhje me pikën d) të nenit 55, paragrafi (1), nëse siguria, jeta dhe shëndeti i njerëzve janë në rrezik të drejtpërdrejt, mund të bëhet pagesë avancë deri 100 % pa asnjë garanci bankare.

Përkundrazi, Ligji për Prokurimet Publike e kufizon shumë e pagesës avancë. Sipas nenit 103 paragrafi (2) të Ligjit për Prokurimet Publike, për autoritetet kontraktuese nga sektori publik klasik, e të cilit i përket Ministria e Punëve të Jashtme, pagesa avancë nuk mund të jetë më e madhe se 20 % nga vlera e kontratës. Gjithashtu, sipas nenit 103 paragrafi (3), autoriteti kontraktues, para se ta bëjë pagesën avancë, duhet të sigurojë një garanci bankare nga bartësi i prokurimit me shumë e dakorduar të pagesës avancë. Kontrata që është lidhur midis dy palëve nuk e parasheh garancinë bankare.

Duke e pasur parasysh këtë, një qasje e tillë mund lehtësisht të vlerësohet si joproporcionale dhe në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së fondeve publike, për shkakun që autoriteti kontraktor, në këtë rast MPJ-ja, paraprakisht e merr përsipër të gjithë rrezikun, pa ndonjë instrument për kthim në rast se kontrata nuk përmbushet. Urgjenca si e tillë nuk është e mjaftueshme për të justifikuar një pagesë avancë prej 100 % pa siguruar asnjë garanci bankare. Urgjenca mund të ndikojë në përzgjedhjen e procedurës, por nuk duhet ta eliminojë sigurinë financiare. Me pagesën e kryer të çmimit të plotë para se të përmbushet shërbimi, autoriteti kontraktues praktikisht mbetet pa asnjë mbrojtje reale në rast se operatori ekonomik vonohet, pjesërisht e përmbush shërbimin ose nuk e përmbush fare. Parimi i shfrytëzimit ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve publike kërkon që rreziku të menaxhohet në mënyrë racionale.

Sa i përket marrëveshjes së nënshkruar, është me rëndësi të theksohet fakti që Ministria e Punëve të Jashtme nuk e ka implementuar modelin standard për prokurimin e shërbimeve të aviacionit, në të cilin përqindja e komisionit që e inkason operatori ekonomik prezantohet veçmas, si përqindje e vlerës së biletës për fluturim ose e aeroplanit që është marrë me hua. MPJ-ja kontratën e ka lidhur në një shumë totale, pa e prezantuar përqindjen e komisionit/

marzhës që do të inkasohet nga ofertuesi i vetëm me të cilin është lidhur kontrata, gjë që e bën të pamundur këqyrjen për vlerën e komisionit të ndërmjetësit.

Ndërsa harxhimet për evakuimin, në vendin tonë janë mbuluar krejtësisht nga ana e shtetit, në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian pasagjerët e transportuar kanë participuar në harxhimet e tyre.

590 pasagjerët u transportuan me katër fluturime – tre nga Dubai në Shkup dhe një nga Riadi në Prishtinë. Rezulton që çmimi për evakuim të një pasagjer prej në Dubai ka qenë 1,548 euro, ndërsa prej në Riad 1,960 euro, duke përfshirë qëndrimin për një natë.

Nga gjithsej 590 pasagjerët e transportuar, 521 janë shtetas të Maqedonisë, kurse 27 janë shtetas të huaj, evakuimi i të cilëve, sipas përgjigjes nga Ministria e Punëve të Jashtme, është zhvilluar në bashkëpunim me ambasadat e vendeve fqinje (Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Kosova, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina).

Pasagjerët në fluturimet e realizuara

Data e fluturimit	Modeli i aeroplanit	Kompania e fluturimit	Numri total i pasagjerëve	Shtetasit e Maqedonisë	Shtetasit e huaj dhe ata me lidhje familjare	Shtetas të huaj të shteteve fqinjë
8.3.2026	Boeing 738-Max	FlyDubai	150	150	0	0
10.3.2026	Boeing 738-Max	FlyDubai	150	127	10	13
11.3.2026	Airbus 320	FlyNas	143	126	9	8
17.3.2026	Boeing 738-Max	FlyDubai	147	118	8	21
Gjithsej pasagjerë			590	521	27	42

Edhe pse kontrata për prokurimin publik parasheh vetëm evakuimin e shtetasve të Maqedonisë, për shërbimet e fluturimit që i kanë shfrytëzuar shtetasit e huaj nuk është kërkuar fare kompensim.

Pishina shkollore në Çair, me vlerë prej 890 mijë euro, 6 muaj ishte e përfunduar vetëm me shkrim

(Tenderi i Komunës së Çairit
për ndërtimin e një pishine të mbyllur
shkollore me numër 14694/2023)



Gjendja e pishinës
më 12 mars 2026,
pothuajse 4 muaj
pas "përfundimit"

- Edhe pse Komuna e Çairit më 21 nëntor 2025 ka dërguar një njoftim në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike që kontrata për ndërtimin e një pishine të mbyllur në SH.F. "Ismail Qemali" është realizuar 100 %, promovimi solemn i këtij objekti u bë madje gjashtë muaj më vonë.
- Komuna e shpalli pishinën si të përfunduar po atë ditë kur ka marrë një raport nga mbikëqyrësi në të cilin janë evidentuar punimet e papërfunduara dhe atëherë ka kërkuar lidhjen e rrjeteve të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit për t'i bërë testimet përfundimtare në pishinën.
- Komuna e Çairit refuzoi të dorëzojë dokumentacion me të cilin do të vërtetohej nëse realizuesi i punimeve është përkuqdesur për mënjanimin e vërejtjeve që janë dhënë mbikëqyrësi, ose nëse është bërë një pranim-dorëzim formal i punimeve të realizuara. Nga Komuna u përgjigjën vetëm pjesërisht ndaj kërkesës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, duke mos i përfshirë pikërisht ato dokumente nga të cilat do të mësohej nëse kontrata ishte në të vërtetë e realizuar.
- Ndërtimi i pishinës fillimisht ishte paraparë të përfundonte në janar të vitit 2025. Në vend që të aktivizonte penalizimin kontraktual të paraparë në nenet 52 dhe 53 të kontratës, Komuna e Çairit e ka vazhduar dy herë afatin e zbatimit me kërkesë nga vetë realizuesi i punimeve.
- Nxitimi për ta paraqitur kontratën si të realizuar vjen në një kohë kur kompania bartëse e kontratës, Eurovia prej Zheline, ndërkohë e riemërtuar si EAKOM nga Tetova, së bashku me një kompani tjetër, kanë konkurruar për një shpallje të re për ndërtimin e një pishine tjetër të mbyllur në Komunën e Çairit, këtë herë në shkollën "7 Marsi".
- Duke e pasur këtë parasysh, nuk mund të përjashtohet mundësia që pishina të jetë lëshuar në funksion vetëm formalisht më 26 maj 2026 - 10 ditë para përfundimit të vitit shkollor, me qëllim që të konfirmohet se kontrata për prokurimin publik është realizuar dhe të minimizohen pasojat nga publikimi i këtij hulumtimi, për të cilin Komuna ishte në dijeni se është në proces të zhvillimit.

Njoftimi për kontratën e realizuar nuk e pasqyron realitetin

Më 21 nëntor 2025, Komuna e Çairit ka dërguar një njoftim në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike (SEPP) që kontrata e prokurimit publik për ndërtimin e një pishine të mbyllur shkollore me vlerë prej 54,772,402 denarë (890,608 euro) është 100 % e realizuar.

Në këtë njoftim bëhet e qartë se kompania bartëse e kontratës së prokurimit publik, Kompania e Ndërtimit, Tregtisë dhe Shërbimeve EUROVIA SHPK Zhelinë e ka ndryshuar emërtimin e vet në Kompania për Ndërtim, Tregti dhe Shërbime EAKOM SHPKPV Tetovë. Megjithatë, ajo që është me rëndësi është se njoftimi për kontratë të realizuar nuk i pasqyron gjendjet reale në terren. Nga vizita në lokacionin në fjalë, më 12 mars 2026, e realizuar nga ekipi i QKQ-së, përkatësisht pas pothuaj 4 muajsh nga dërgimi i këtij njoftimi, rezultoi se pishina është larg fazës së përfunduar. Punë të papërfunduara janë vërejtur edhe brenda edhe jashtë objektit të pishinës.

Prandaj, më 6 prill 2026, deri te Komuna e Çairit është dorëzuar një kërkesë për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, duke kërkuar që të dorëzohen dokumentet dhe informacionet si më poshtë:

1. Vendimi për prokurimin publik;
2. Raport mbi procedurën e zhvilluar për prokurimin publik;
3. Raport nga ankandi elektronik i zhvilluar;
4. Data e fillimit me punë nga bartësi i prokurimit;
5. Plani dinamik për realizimin e punimeve i paraqitur nga bartësi i prokurimit;
6. Njoftimi që i është dërguar Komunës nga bartësi i prokurimit, e në të cilin bartësi i prokurimit pohon se punimet që janë lëndë e kontratës janë përfunduar duke paraqitur dokumentacionin e nënshkruar në mënyrën përkatëse nga Autoriteti Mbikëqyrës (detyrim i paraparë në nenin 31 të Kontratës);
7. Procesverbali nga pranim-dorëzimi i punimeve të realizuara;
8. Përlllogaritja përfundimtare e vlerës së objektit në përputhje me dispozitat e nenit 6 të kontratës me operatorin ekonomik;
9. A është përlllogaritur dhe paguar penal kontraktual në përputhje me nenet 52 dhe 53 të kontratës; si dhe
10. Për çfarë arsye pishina ende nuk është lëshuar në funksion edhe pse 4 muaj më parë në SEPP është dërguar njoftimi për realizim të përmbyshur të kontratës?

Komuna nuk i dorëzoi dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, dhe pas kësaj më 27 prill është parashtruar ankesë në Agjencinë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik. Më 4 maj, Komuna i dorëzoi informacionet nga pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 me sqarimin në vazhdim: “Sa u përket detyrimeve kontraktuale, ato janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, pa u shfaqur nevoja për ndërhyrje shtesë. Gjithashtu, objekti ende nuk është lëshuar në përdorim, në përputhje me konstatimet nga Raporti i inxhinierit mbikëqyrës për inspektimin e kryer teknik.”

Nga dokumentet që i morëm, rezulton që kompania përgjegjëse për mbikëqyrjen, URBAN STILL INZHENERING Shkup, më 30 shtator 2025, e ka informuar Komunën e Çairit se realizuesi i punimeve EUROVIA i kishte informuar ata se punimet ndërtimore për ndërtimin e pishinës së mbyllur shkollë kishin përfunduar dhe se do të caktohej një datë për pranimin teknik të brendshëm të objektit. Kjo nuk është një ditë e rastësishme. Pikërisht më 30 shtator ka skaduar afati i tretë me radhë i dakorduar për ndërtimin e pishinës. Domethënë, kontrata për ndërtimin është nënshkruar më 28.11.2023 me një periudhë vlefshmërie prej 14 muajsh, apo deri më 28.01.2025. Pas kësaj kanë pasuar 2 anekse për vazhdimin e afatit për realizimin e kontratës, i pari deri më 31.05.2025, ndërsa i dyti deri më 30.09.2025. Gjatë ndërtimit të pishinës, Komuna e Çairit ka pas mundësinë që të aktivizojë një penalitet kontraktual të paraparë në nenet 52 dhe 53 për shkelje të afateve të dakorduara. Megjithatë, në vend të këtij veprimi, Komuna dy herë e ka vazhduar afatin e realizimit me kërkesë nga vetë realizuesi i punimeve. Përveç kësaj, si një nga arsyet e cekura për vonesën është përmendur vënia e vonuar në punë e realizuesit të punimeve. Në këtë mënyrë, Komuna së pari e ka krijuar pengesën, ndërsa më pas këtë e ka pranuar si arsyetim që të mos e zbatojë penalitetin kontraktual, por ta aneksojë kontratën e prokurimit publik.

Duke qenë se kontrata është nënshkruar më 28.11.2023, me periudhë vlefshmërie prej 14 muajsh, përkatësisht deri më 28.01.2025, ndërsa kontraktori është vënë në punë jo më herët se data 17.05.2024, rezulton se fillimi real i realizimit të kontratës është prolonguar përafërsisht gjashtë muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Fillimi i këtillë i vonuar i futjes në punime mund të sugjerojë në transparencë të pamjaftueshme në lidhje me dinamikën reale kohore të realizimit të kontratës. Fillimi i vonuar i punimeve, nëse nuk ka qenë qartë paraprakisht i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit ose në kushtet e procedurës, mund të konsiderohet si një rrethanë e cila potencialisht e kufizon konkurrencën. Pra në këtë mënyrë, jo të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar kanë pasur në dispozicion informacione të plota dhe të sakta në lidhje me fillimin e saktë të realizimit të kontratës, gjë që është në kundërshtim me parimin e transparencës dhe mund të ketë ndikim mbi qasjen e barabartë dhe konkurrencën në procedurën për prokurime publike.

Raporti nga inxhinieri mbikëqyrës për inspektimin teknik të pishinës është përgatitur pothuajse 2 muaj pas njoftimit që pishina është ndërtuar, përkatësisht jo më herët se më datë 21.11.2025. Pas inspektimit të kryer teknik, në raportin e mbikëqyrjes nga autoriteti mbikëqyrës janë paraqitur vërejtjet, konstatimet dhe instruksionet si më poshtë:

“Më datë 18.11.2025, bazuar në kërkesën e realizuesit të punimeve, në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Mbikëqyrës, Investitorit dhe Realizuesit DGTU EUROVIA SHPKPV Zhelinë, është zhvilluar një Inspektim Teknik mbi punën e kryer në lidhje me objektin “Ndërtimi i pishinës së mbyllur shkollore, Komuna Çair” dhe është konstatuar se kjo është bërë në përputhje me Dokumentacionin e Projektit, kërkesat nga Investitori, Marrëveshjen Bazë dhe ndryshimet e marrëveshjes, lejet nga institucionet kompetente si dhe me ligjet dhe standardet në fuqi.

Gjatë inspektimit të detajuar mbi objektin e ndërtuar, Autoriteti Mbikëqyrës i konstatoi vërejtjet e mëposhtme që duhet të mënjanojnë dhe të kryhen nga Realizuesi:

- Duhet të bëhet ndërrimi i një xhami të çarë në derën e përparme;
- Të bëhet korrigjim dhe nivelim i të gjitha dyerve të hyrjes në objekt;
- Të bëhet korrigjim dhe nivelim i dyerve të brendshme të tualeteve;
- Të bëhet zëvendësimi i tre listelave të sipërme të përthyera në nyjat e panelit të fasadës;
- Të bëhet korrigjim i ndarjeve përpara tualeteve;
- Të bëhet korrigjim i pllakave të dyshemesë rreth grilës së pishinës duke i stikuar ato;
- Të bëhet korrigjimi i pragjeve në muret e dyerve të hyrjes me bekaton;
- Të bëhet testimi përfundimtar i instalimeve hidroteknike si dhe i shtratit të pishinës pas vendosjes së lidhjes së ujësjellësit dhe kanalizimit nga NP Ujësjellës dhe kanalizim Shkup;
- Të bëhet testimi përfundimtar dhe kalibrimi i pajisjeve mekanike pas vendosjes së lidhjes për instalimin elektrik nga EVN-ja;
- Të bëhet testimi përfundimtar i pajisjeve elektroteknike pasi të vendoset lidhja e instalimit elektrik nga EVN-ja;

Autoriteti mbikëqyrës i konstatoi punimet e mëposhtme që ende nuk janë përfunduar, ndërkaq të cilat duhet të përfundohen si detyrim nga Investitori, Komuna e Çairit, para se të bëhet Pranimi përfundimtar teknik i objektit:

- [Duhet të lidhet objekti me instalimet e ujit dhe kanalizimit – NP Ujësjellës dhe Kanalizim Shkup](#)
- [Duhet të lidhet objekti me furnizimin me energji elektrike – EVN](#)


Autoriteti mbikëqyrës ka kërkuar nga Realizuesi i punimeve që të përkujdeset për mënjanimin e vërejtjeve të konstatuara brenda afatit prej 30 ditëve pune. Investitori, Komuna e Çairit, duhet t'i bëjë lidhjet e lartpërmendura në mënyrë që të bëhen testet e nevojshme që janë relevante për funksionimin e papenguar dhe adekuat të objektit në tërësi."

Mirëpo, edhe pse në këtë raport janë paraqitur shumë vërejtje nga autoriteti mbikëqyrës, kjo nuk ka qenë pengesë për Komunën e Çairit, që në ditën kur e ka pranuar raportin, pra më 21.11.2025, ta dërgojë njoftimin në ESPP se kontrata për ndërtimin e pishinës është realizuar plotësisht.

Megjithatë, fotografitë që janë bërë brenda objektit të pishinës më 12 mars 2026 nga ekipi i QKQ-së tregojnë se punimet janë larg fazës së përfunduar. Përveç kësaj, është më se e dukshme se vërejtjet që janë konstatuar nga mbikëqyrësi nuk janë mënjeluar edhe pas gati 4 muajsh, domethënë se nuk është bërë asnjë testim përfundimtar, që është e vetmja formë relevante për të konstatuar nëse realizuesi i punimeve me të vërtetë e ka realizuar kontratën në tërësi dhe në përputhje me projektin.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, më pas janë bërë përpjekje shtesë që të sigurohen informacione më të hollësishme nga Komuna e Çairit lidhur me çështjen përse pishina nuk lëshohet në përdorim. Nga Komuna kemi kërkuar që t'i dërgonte dokumentet e kërkuara më parë, si dhe të dorëzojë prova se është vepruar sipas gjetjeve nga inspektimi i kryer.

Pishina nuk është lëshuar në funksion dhe aktivitetet përreth këtij objekti ishin ende në rrjedhë edhe deri më datë 21 maji 2026, kur ekipi i QKQ-së përsëri e vizitoi objektin e pishinës. Në këtë datë, kishin kaluar saktësisht 6 muaj nga dërgimi i njoftimit për kontratë të realizuar.



Pishina më 12 mars 2026



Pishina më 21 maj 2026

Megjithatë, objekti i pishinës është shpallur si i hapur më 26 maj 2026. Duke e pasur parasysh këtë, nuk mund të përjashtohet mundësia që pishina të jetë lëshuar në funksion më 26 maj 2026 - vetëm 10 ditë para përfundimit të vitit shkollor, vetëm formalisht, me qëllimin që të konfirmohet se kontrata e prokurimit publik është realizuar.

Nxitimi për ta paraqitur kontratën si të realizuar, plot 6 muaj para se kjo të bëhej realitet, ka ndodhur në një kohë kur kompania bartëse e kontratës, Eurovia prej Zhelinës, me emërtim të ndryshuar në EAKOM prej Tetovës, së bashku me një kompani tjetër bëhen gati të konkurrojnë për një shpallje të re për ndërtimin e një pishine tjetër të mbyllur në Komunën e Çairit, këtë herë, në shkollën “7 Marsi”. Kontrata për ndërtimin e pishinës së re në Komunën e Çairit është nënshkruar më 27 janar 2026 me një grup ofertuesish: Kompania e Ndërtimit, Tregtisë dhe Shërbimeve NUM KONSTRAKSHËN LTD SHPKPV Shkup dhe Kompania e Ndërtimit, Tregtisë dhe Shërbimeve EAKOM SHPKPV-SHKUP. Ky dysh kanë qenë ofertuesit e vetëm në tenderin e shpallur. Ndërtimi i pishinës së re ka filluar më 4 mars 2026. Vlera e objektit të pishinës së re është 61,138,707 denarë (994,125 euro).

Përndryshe, regjistrimi i informacioneve në Sistemin Elektronik të Prokurimeve Publike se kontrata është realizuar, në situatë kur ajo faktikisht nuk është e realizuar, përbën futje të të dhënave të rreme dhe është në kundërshtim me parimet e transparencës dhe integritetit që janë të përcaktuara me Ligjin për Prokurimet Publike. Sjellja e tillë mund të çojë në prezantim të gabuar të shkallës së realizimit të kontratave, të ndikojë mbi saktësinë e raporteve dhe të krijojë rrezik nga fshehja e parregullsive. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave të futura i përket autoritetit kontraktues, përkatësisht personit zyrtar të autorizuar, i cili e bën regjistrimin e atyre të dhënave.

Kronologjia e tenderit për ndërtimin i pishinës së mbyllur shkollore

15.8.2023: Komuna e Çairit miraton Vendimin për prokurim publik për ndërtimin e pishinës së mbyllur shkollore me vlerë të paraparë prej 49.999.998 denarë me TVSH.

16.08.2023: Komuna e Çairit e publikon shpalljen për prokurimin publik.

25.09.2023: Janë dorëzuar 4 oferta: Kompania për ndërtim, projektim, tregti dhe shërbime GONI LINUX SHPKPV Shkup; Kompania për ndërtim, tregti dhe shërbime EUROVIA SHPK Zhelinë; Kompania për ndërtim, prodhim, tregti dhe shërbime import-eksport BITEM SHPK Shkup dhe Kompania tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime INSTALLACIJA import-eksport Ismail SHPKPV fshati D. Doll Zajas.

16.10.2023: Zhvillohet ankandi elektronik, në të cilin marrin pjesë tre nga katër kompanitë (EUROVIA, BITEM dhe INSTALLACIJA), ndërsa vetëm EUROVIA merr pjesë në uljen e çmimit, e cila e ul çmimin e saj edhe ashtu të ulët nga 52,917,290 denarë në 46,417,290 denarë pa TVSH.

25.10.2023: Komuna e Çairit sjell një vendim me të cilin e rrit vlerën e prokurimit në 54,772,402 denarë duke përfshirë TVSH-në.

28.11.2023: Komuna e Çairit nënshkruan një marrëveshje me kompaninë EUROVIA Zhelinë me afat vlefshmërie prej 14 muajsh, përkatësisht deri më 28 janar 2025.

17.05.2024: Futje e realizuesit në procesin e punës.

28.01.2025: Është nënshkruar Aneksi nr. 1 i Marrëveshjes për prolongimin e afatit për realizim të marrëveshjes deri më 31.05.2025.

01.06.2025: Është nënshkruar Aneks nr. 2 i Marrëveshjes për prolongimin e afatit për realizim të marrëveshjes deri më 30.09.2025.

30.09.2025: Autoriteti mbikëqyrës - URBAN STILL INZHENERING Shkup i dorëzon Komunës së Çairit një Njoftim nga realizuesi, drejtuar autoritetit kontraktues se punimet janë përfunduar - kërkesë për pranim teknik.

18.11.2025: Autoriteti mbikëqyrës e dorëzon Raportin nga inxhinieri mbikëqyrës për inspektimin teknik të kryer.

21.11.2025: Komuna e Çairit dërgon një Njoftim në SEPP për realizimin e plotë të kontratës.

26.05.2026: Pishina zyrtarisht është shpallur si e hapur.



Kingdom of the Netherlands

Ky hulumtim është zhvilluar në kuadër të projektit “Mbikëqyrje Publike mbi Prokurimet Publike” me ndihmë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, të cilin e implementon Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 tetori 2025 deri më 30 shtator 2027.